



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:068982
Datë: 14.03.2023
Numri i dokumentit: 04078388

C.nr.1073/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses M. B., nga Peja, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Mujaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Komuna e Pejës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për çështjen juridike, kompensimin e shujtave ditore, jashtë shqyrtimit, me 15 mars 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. MIRATOHET marrëveshja jashtëgjyqësore me nr. të referencës së ndërmjetësimit Ndr.nr.127/22 datë 24.01.2023, e lidhur në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë, me datë 24.01.2023 në mes të paditëses M. B., nga Peja dhe të paditurës Komuna e Pejës – Drejtoria Komunale e Arsimit për çështjen juridike kompensimin e shujtave ditore.
- II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Ndr.nr.127/22, datë 24.01.2023.

A r s y e t i m

Paditësja M. B. me datë 14.04.2021, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me bazë juridike kompensim i shujtave ditore.

Gjykata pas pranimit të lëndes dhe pasi që vlerësoj se e njëjta është e përshtatshme për ndërmjetësim, me vendimin C.nr.1073/21, datë 23.12.2022, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Ndërmjetësimin, lëndën në fjalë e ka referuar në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë (për trajtim të mëtejme), e cila është regjistruar me numrin e referencës së ndërmjetësimit Ndr.nr.127/22.

Qendra për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë, me datë 24.01.2023, ka njoftuar Gjykatën dhe palët, në rastin konkret lidhur me arritjen e marrëveshjes jashtëgjyqësore pranë Qendrës së lartëcituar dhe gjykatës ia ka dorëzuar ekzemplarën e marrëveshjes për zgjidhjen e kësaj çështje sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit me Ndr.nr.127/22, datë 24.01.2023 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në mes të paditëses M. B. nga Peja dhe të paditurës Komuna e Pejës – Drejtoria Komunale e Arsimit (për me tepër sikurse në marrëveshjen Ndr.nr.127/22, datë 24.01.2023, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë vlerësoj se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3.3 dhe 411 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e lidhur me nenin 3, paragrafi 1, pika 1.6, neni 8, 10, 12, 14 dhe 15 paragrafi 1, të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr.06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të miratohet për faktin se e njëjta përmban vullnetin e palëve në procedurë dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1073/21, me 15 mars 2023

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.